



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

Nr. 21211 Prot,

Tiranë, më 04. 05. 2018

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: "Ora Film" sh.p.k.

Rruga "A. Moisiu", nr. 76, Tiranë

I nderuar zoti ÇASHKU,

Lidhur me kërkesën Tuaj të datës 24 Prill 2018, në të cilin kërkonti "rimbledhjen e KMP për të marrë në shqyrtim projektin e IHRFFA 13...", shprehemi:

Thirrja për aplikime për projekte të ndryshme kinematografike, ku përfshihen edhe projektet për festivale e javë filmi, në muajin Mars, është tashmë traditë që ndiqet nga kineastët prej disa vitesh.

QKK, nuk mund të jetë përjashtuese në thirrjet për aplikime, pasi kjo bie ndesh me interesin e saj, përkundrazi, QKK është e interesuar të aplikojnë sa më shumë projekte, në mënyrë që të krijohet terreni i përshtatshëm për të përzgjedhur dhe mbështetur financiarisht projektet më të mira.

Njoftimi zyrtar për hapjen e sezonit të konkurseve, datë 01.03.2018, përfshinte filmin artistik me metrazh të shkurtër, filmin dokumentar, filmin e animuar, si dhe festivalet e filmit. Njoftimi zyrtar i QKK, për hapjen e sezonit të konkurseve, ka qenë maksimalisht eficient dhe falë tyre prurjet kanë qenë optimale. Në përfundim të afatit të aplikimit rezultoi se paraqitën aplikimin e tyre për mbështetje financiare 42 projekte kinematografike, si edhe të gjithë festivalet e filmit që tashmë janë bërë traditë të zhvillohen në Shqipëri, gjë që tregon se njoftimi i bërë nga QKK në faqen web, si dhe në rrjetet sociale, ka funksionuar për të gjithë ata që kanë qenë të interesuar.

Më konkretisht, njoftimi me titull "Thirrje për aplikim", është publikuar në faqen web të QKK, <http://nationalfilmcenter.gov.al/>, e cila është faqja

zyrtare e hostuar në AKSHI, e cila mban datën 1 Mars 2018. Nga ky publikim është marrë linku i cili është publikuar më pas në Facebook në faqen e QKK <https://www.facebook.com/pg/AlbanianFilmCenter/>.

Ky link është publikuar në Facebook në datat e mëposhtme:

1 Mars 2018, i cili sipas Facebook ka arritur këto statistika:

3,434 people reached

42 Reactions

68 Like

28 Shares

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=940918616082222&id=277062239134533

Njoftimi i datës 1 Mars 2018, është shpërndarë në 28 faqe të tjera në Facebook, si dhe është ripublikuar sërish në faqen e QKK në Facebook, në datat e mëposhtme:

- 7 Mars 2018:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=944503515723732&id=277062239134533

- 15 Mars 2018:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=949191251921625&id=277062239134533

- 17 Mars 2018:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=950506595123424&id=277062239134533

Gjithashtu njoftimi është publikuar në datën 7 Mars 2018 edhe në faqen e QKK në Instagram:

<https://www.instagram.com/p/BgBYckgHdEw/?hl=en&taken-by=nationalfilmcenter>

Të gjitha këto publikime janë lehtësisht të verifikueshme.

Njoftimi për hapjen e sezonit të konkurseve është publikuar në të njëjtën faqe të Facebook, ku ju keni parë njoftimin e publikuar për rezultatin e

mbledhjes së KMP, lidhur me projektet kinematografike për të cilat është miratuar mbështetje financiare.

Në mbyllje, jam i detyruar të konfirmoj se kërkesa Juaj nuk mund të pranohet, sepse QKK nuk mund dhe nuk duhet të kualifikojë një projekt i cili nuk e ka kryer aplikimin brenda afatit, si dhe në formën e përcaktuar.

Gjykojmë që ky veprim do të ishte një shprehje e mungesës së respektit ndaj të gjithë aplikantëve të tjerë, të cilët aplikuan korrektësisht brenda afatit kohor të përcaktuar.

Ju falënderoj për mirëkuptimin.

KRYETARI


Ilir BUTKA

